



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.78/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi, kryesues, Hajriz Hoti, dhe Violeta Husaj Rugova - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Kosova Demokratik Türk Partisi (KDTP), të parashtruar kundër Subjektit politik Yenilkçi Türk Hareket Partisi (YTHP), me seli në Komuna Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 01.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET E PA BAZUAR ankesa e subjektit politik, Kosova Demokratik Türk Partisi (KDTP), ZL.Anr.78/2025, e datës 29.09.2025, parashtruar kundër subjektit politik, Yenilkçi Türk Hareket Partisi (YTHP), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 29.09.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.78/2025, nga subjekti politik, Kosova Demokratik Türk Partisi me të cilën pretendon se më datë 27.09.2025, në një imazh të publikuar në llogarinë e tij në rrjetet sociale, anëtari i Yenilkçi Türk Hareket Partisi ,Edin Kude si dhe njëherit kandidat i së njëjtës parti për anëtar të Kuvendit Komunal të Prizrenit, ka publikuar një listë ku figurojnë emrat Berna Biba Jorgaxhi, Sevgi Hapçi, dhe Neela Subi Tabaku kandidatë për anëtare të Kuvendit Komunal të Prizrenit nga subjekti politik Kosova Demokratik Türk Partisi. Në tekstin e postimit përdoren shprehjet *"A është ndonjë kandidat për anëtar të kuvendit komunal që i është premtuar punë? Hajde flasim edhe me dokumente"*.

Parashtruesi i ankesës tutje shton se ky postim përbën një akuzë të drejtpërdrejtë që jep përshtypjen se kandidatët janë në garë me premtime për punë, sipas tyre kjo dëshmon dëm të reputacionit profesional të kandidatëve, të drejtave të tyre personale, dhe legjitimitetit të fushatave të tyre zgjedhore.

Sipas parashtruesit të ankesës, shprehjet e përdorura në këtë postim diskreditojnë motivimin e kandidatëve, dhe reputacionin profesional të kandidatëve në sy të publikut; ato krijojnë një efekt mashtrues, denigrues, dhe stigmatizues që mund të ndikojë në mënyrë të padrejtë në vlerësimin e kandidatëve nga zgjedhësit. Këto lloj kualifikimesh dëmtojnë integritetin e garës demokratike dhe përbëjnë ndërhyrje të padrejtë në fushatën zgjedhore të kandidatëve.

Me këtë, parashtruesi i ankesës pretendon se Edin Kude sipas dispozitave të Ligjit nr.08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenin 34, gjatë periudhës së fushatës është i ndaluar përdorimi i gjuhës apo materialeve që nxisin, përhapin urrejtje ose cenojnë dinjitetin e individëve. Postimi në fjalë sipas parashtruesit të ankesës përmban akuza ndaj personave të tretë (kandidatët), duke përbërë shkelje të kësaj dispozite.

Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur përmbajtjen e postimit dhe materialin vizual të datës 27.09.2025 në rrjetin social Facebook të Edin Kude.

Subjekti politik Yenilkçi Türk Hareket Partisi dhe kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal të Prizrenit Edin Kude nuk i është përgjigjur ankesës dhe nuk i ka kundërshtuar pretendimet e parashtruesit të ankesës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Yenilkçi Türk Hareket Partisi (YTHP), Paneli i vlerësoj se janë të pabazuara dhe nuk janë bindëse, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që imazhi i publikuar në llogarinë sociale të anëtarit të Kuvendit Komunal të Prizrenit, Edin Kude, ku në tekstin e postimit përdoren shprehjet "*A është ndonjë kandidat për anëtar të kuvendit komunal që i është premtuar punë? Hajde flasim edhe me dokumente*", sipas vlerësimit të Panelit, ky postim, dhe deklaratë nuk është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht me dispozitat nenit 34 par 1 pika 1.11 të LZP-së. Imazhi i publikuar në llogarinë sociale të anëtarit të Kuvendit Komunal të Prizrenit nuk përmban fjalor që nxit apo provokon, ose që mund të nxis një person tjetër për të kryer akt të dhunës kundër personave tjerë.

Andaj, duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi nga parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lartë se përbëjnë shkelje të kodit të mirësjelljes.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënën 117 par. 3, lidhur me nënën 118 pa. 1 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.78/2025 datë 01.10.2025

**Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi**



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nënit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.